



Departamenti i Prokurimit

Prishtina: datë, 03.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.11.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Procogroup&Floring”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “, **Ndërtimi i çerdhes “Xixëllonjat”**, , me Nr. të Prok: **616 21 135 511** nxjerr:

VENDIM

1. **Aprovohet pjesërisht** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Procogroup&Floring” të dt. 30.11.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘**Ndërtimi i çerdhes “Xixëllonjat”** me Nr. **616 21 135 511**, kundër Vendimi për anullim të aktivitetit të datës 23.22.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Anulohet vendimi i AK për anulim të këtij aktiviteti i publikuar me datë: 23.11.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kthej aktiivitetin në rivlerësim* ;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kerkesen me datën 03.12.2021 dhe ka konstatuar si vijon:


- Pretendimi juaj se nuk janë krijuar kushte për trajtimin e tenderit tuaj si tender me çmim jonormalisht të ulët sipas pikës 3.1 të Rregullave për tenderët jonormalisht të ulët nuk është plotësuar është i qëndrueshëm, mirëpo Autoriteti Kontraktues është bazuar në pikën 3.2 të Rregullores dhe ka kërkuar sqarimet lidhur me disa çmime për të cilat ka konstatuar se janë jonormalisht të ulta. Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe duke analizuar përgjegjet tuaja dhe konstatimet e komisionit konsideroj se konstatimi i komisionit nuk është dhënë i argumentuar në detaje, por vetëm është dhënë konstatimi se arsyetimet nuk janë të mjaftueshme. Pra bazuar në këtë konsideroj se pretendimi juaj duhet të pranohet;
- Deklarimi juaj se mund të pranoni rritjen e sigurimit të ekzekutimit deri në 30% besoj që mund ta krijoj një siguri për realizimin e projektit dhe kjo është një arsye shtesë për ta rivlerësuar tenderin tuaj duke u bazuar në faktin se kemi të bëjmë me tenderin me çmimin më të ulët. Bazuar në këto konstatime kam vendosur që aktiviteti të kthehet në rivlerësim dhe në atë fazë një komision profesional të trajtoj drejt arsyeshmërinë e sqarimeve të kërkuara dhe mundësinë e rritjes së sigurisë së ekzekutimit, si garancë për realizimin e projektit me çmimin e dhënë në tenderin tuaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, mund të paraqitet ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas publikimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit